



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit të cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit të shërbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

GRUPI I OPERATOREVE "NATONI" shpk & "KABASHI" NN të cilën e përfaqëson I autorizuari z. Naton Kabashi, nga Istogu me Nr. Rexhistrimit të biznesit: 810149478 ne vazhdim "Furnizuesi", ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet si me poshtë:

MBLEDHJA E ARTIFAKTEVE DHE EKSPONATAVE PËR MUZE TË QYTETIT

Nr. I prokurimit	633-18-6769 2-2-1/ C 174 –Lot 2
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 066/ 221 - Lot 2

Neni 1 Lënda

1.1 MBLEDHJA E ARTIFAKTEVE DHE EKSPONATAVE PËR MUZE TË QYTETIT

1.2 Kontraktuesi është i obliguar që Brenda afatit 45 Ditor të bëjë furnizimin SIPAS specifikave dhe pershkrimit teknik.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e të gjitha furnizimeve do të jetë: 20 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Komuna e Istogut **DIREKTORATI PER RINI SPORT E KULTURË NE KOMUNËN E ISTOGUT.**

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi I dates 04.10.2018

Vlera e kontrates është 9.574,00 € dhe me shkronja Nëntë mijë e pesë qind e shtatëdhjetë e katëre euro

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetnja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet



6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin

titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]² in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Furnitorin:	
Komuna e Istogut		Grupi i OE "NATONI" & "KABASHI"	
Emri:	Zize Bujupaj	Emri:	Naton Kabashi
Pozita:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	5.12.2018	Data:	05.12.2018
Vula:		Vula:	